

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor gjatë vitit 2024 ka synuar të rrisë cilësinë artistike në vend duke e kthyer TKOBAP-në në një Teatër Evropian, me krijimin e një Kalandari të pasur Artistik me premiera dhe rivënie të suksesshme.

Fillimisht me promovimin dhe fuqizimin e talenteve të reja, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për çdo grupmoshë, me ndërtimin e Korit të Zërave të Bardhë dhe krijimin e platformës “Opera për Fëmijë dhe Familje” si dhe me ndërtimin e të parit program profesional “Akademia Teatrale”.

Qasja që Shqipëria ka treguar në fushën e artit ka tejkaluar kufijtë historik të rajonit të Ballkanit Perëndimor, duke promovuar dhe fuqizuar akoma më tepër kulturën tonë artistike. Me qëllim ndërtimin e një shoqërie me shtylla të forta kulturore, jemi angazhuar në krijimin e programeve që sjellin zhvillim të qëndrueshëm dhe punësim, duke huazuar nga përvojat më të suksesshme evropiane si dhe krijuar ura bashkëpunimi me partnerë të besueshëm dhe të qëndrueshëm brenda Republikës së Shqipërisë, rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe në Evropë, përmes gjuhës universale të muzikës. Për të arritur objektiva, ne jemi angazhuar në katër fusha kryesore:

Menaxhim strategjik

- Garantimi i vazhdimësisë së veprimtarisë artistike të institucionit brenda TKOBAP dhe On tour **duke ruajtur formatin e plotë skenik të titujve operistikë dhe baletit.**
- Ngritje dhe mobilizim i fondeve të reja, nga okupimet, shitja biletave dhe sponsorizime

Menaxhim artistik

- TKOBAP - si institucion i ekselencës – do të jetë vendtakimi për me të talentuarit: kengetare, balerine, dirigjente, regjizore, koreograf etj nga vendi dhe bota
- Kalendar artistik me repertor divers, me synim terheqjen e audiencave të gjitha moshave dhe interesave, me tendence të rinj dhe femijet
- Terheqja e talenteve të reja, dhe trajnimi i tyre me ekselencë të shqiptare dhe të huaja

Projekte edukimi

- Veprat me të mira të artit muzikor, koreografik, dhe folklorik i ofrohen fëmijëve të shkollave për t’i afruar ata me artin klasik, tradicional dhe të huaj, duke i bërë vete pjesëmarrës në veprat e ofruara

Menaxhim ekzekutiv dhe komunikimi

- Aplikimi i metodave bashkëkohore të komunikimit, promocionit, dhe marketingut të produksioneve për terheqjen e audiencave, partnereve, sponsorve, medias, etj.

- Të permiresojme menaxhimin e buxhetit ekzistues nepermjet menaxhimit ne menyre efikase te kostove, si dhe te identifikojme burime te reja duke maksimizuar ngritjen e fondeve, shitjen e biletave, dhe të ardhurat komercial.
- Ngritja e sistemit - planifikim- raportimi, jo vetem operacional për monitorimin e realizimin e shfaqeve të rradhës por edhe esencial sa i perket problematikave dhe ideve te reja te organizimit.

I. Performanca artistike dhe menaxheriale

Kalendar artistik me repertor divers dhe ekselence ekzekutimi, me synim tërheqjen e audiencave të të gjitha moshave dhe interesave, me tendencë të rinjtë dhe fëmijet, artdashësit etj..

Tërheqja e talenteve të reja, dhe trajnimi i tyre ndër vitet 2021,2022,2023 dhe 2024.

Tabela e mëposhtme sqaron rritjen e performancës artistike nga viti në vit.

Kategori	2021	2022	2023	2024
OPERA				
Produksion i ri			2	5
Premierë	0	9	5	0
Rivënie	14	9	17	18
Koncerte Simfonike				
Produksion i ri				0
Premierë		30	33	14
Rivënie	6	16	1	6
Balet				
Produksion i ri			3	2
Premierë	2	9	11	5
Rivënie	9	7	15	18
Ansambli Popullor				
Produksion i ri	3			0
Premierë		6	4	0
Rivënie	5	3	5	9
Shf. Për familje dhe fëmije	14	10	15	14
Masterclass		8	30	
Koncert Holli	13	11	8	22
TKOBAP ON TOUR				
Opera			9	1
Koncert			16	20
Balet		2	3	10
AP	3	6	15	31

Numri i publikut:

- +31,935 persona kanë ndjekur shfaqjet e sezonit artistik Janar – Dhjetor 2024 fizikisht
- 28,825 persona kanë ndjekur shfaqjet e sezonit artistik Janar – Dhjetor 2023 fizikisht
- 15,639 persona kanë ndjekur shfaqjet e sezonit artistik Janar – Dhjetor 2022 fizikisht
- 7,911 persona kanë ndjekur shfaqjet e sezonit artistik Janar – Dhjetor 2021 fizikisht

Duket qartë se gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024 kemi një rritje të audiencës, kjo për faktin e larmishmërisë së veprave artistike dhe promovimit të këtyre veprave.

-Trajnimi dhe promovimi i talenteve të reja dhe edukimi i publikut me veprat më të mira të teatrit muzikor koreografik dhe folklorit të përpunuar

Ky është një nga objektivat afatgjatë të TKOBAP, do të jemi udhëheqësit artistike për gjeneratën e ardhshme me synimin ngritjen e Departamentit të Edukimit.

Gjatë këtij viti teatri ynë ka punuar me shumë pasion për identifikimin, inkurajimin dhe trajnimin e artistëve të rinj balerinë, këngëtare, instrumentistë, regjisorë, skenografë të gjithë të talentuar, të cilët do të garantojnë teatrin e të ardhmës, zhvillimin artistik dhe profesional të saj të sektorëve teknikë. Pjesë e rëndësishme është dhe bashkëpunim që do të realizojmë me Universitetin e Arteve, Liceun Artistik, Shkollën e baletit, si një projekt programesh zhvillimi përmes së cilëve në do i japim mundësi zhvillimi, balerinëve, këngëtarëve, instrumentistëve dhe krijuesve të rinj nën guidën e profesionistëve të Teatrit.

Ky proces trajnues i cili tashmë ka dhënë frutet e veta tek talentet e trajnuara të Operës, Baletit dhe Ansambllit të cilët kanë përfutur pjesmarrjen me kontrata edhe në rolet kryesore të kalendarit të teatrit apo më shumë se kaq edhe emërime në teatrin tonë, apo benifite të ngritjes së karrierës, do të vazhdojë edhe me instrumentistët dhe talentet e tjera të kostumografisë, skenografisë light dizajn, videoartist, por dhe të PR-marketing, përmes programeve dhe projekteve të ndryshme të zhvillimit të talentëve etj.

1. Punësimi i të rinjve. Sipas ligjit nr. 75/2019 “Për rininë” *“Të rinj” janë personat, i ri ose e re, që kanë mbushur moshën deri në 29 vjeç*”. Në Drejtorinë e Operës dhe Filarmonisë, punësim vjen me orkestrantët S.H. dhe Xh.S, në Drejtorinë e Baletit me pianisten S.Z, me ngritjet në detyrë nëpërmjet audicioneve të ndjekura nga komisione *ad hoc* të të rinjve që ishin tashmë të punësuar, si solistët lirikë: A.V dhe M.XH.
2. Angazhimi artistik i të rinjve. Ligji nr. 75/2019 “Për rininë” përcakton se *"Puna rinore realizohet nëpërmjet angazhimit dhe aktivizimit të të rinjve në veprimtari që reflektojnë nevojat, interesat, idetë dhe eksperiencat e tyre. Nëpërmjet këtij procesi të të nxënit joformal, të rinjtë fitojnë njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime që nevojiten për zhvillimin personal, integritetin social dhe qytetarinë aktive"*. Angazhimi i të rinjve, përveçse në skenën e TKOBAP-së dhe në qytete të Shqipërisë, për shkak të Kalendarit Turistik Veror, por jo vetëm, është realizuar edhe në aktivitete të cilat janë zhvilluar në skenat ndërkombëtare si rasti i balerinës G.S në: Cinema Teatro Vivaldi – Jesolo, Cinema Teatro – Mirano, Teatro Comunale Ballarin Lendinara, Teatro Sociale – Cittadella, i valltarëve: A.M, S.B etj., për Festivalin e 32-të ndërkombëtar folklorik në Varna, Bullgari etj.

Të rinjtë e angazhuar kanë ardhur në vijim dhe në përfundim të studimeve në Universitetin e Arteve sipas parashikimeve në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Shkollën Koreografike, në disa prej shkollave 9-vjeçare të kryeqytetit pjesëmarrëse në projektin “Eja këndo me ne VII” në kuadër të programit të “Edukimit përmes Kulturës”.

3. Kori i Zërave të Bardhë. Zgjerimi me realizimin e audicionit të datës 26.3.2024 dhe rritja e pjesëmarrjes së tyre në aktivitete të organizuara nga TKOBAP-ja si në koncertet: “Nëntori i yjeve të artë”, “Tingujt që sollën lirinë”, “A Ceremony of Carols” etj., me qëllim zbatimin e ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” i cili ndër të tjera parashikon se: *“Autoritetet publike qendrore e vendore, brenda kompetencave të tyre, marrin masa konkrete për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe mundësive të barabarta për ushtrimin e aktiviteteve kulturore, artistike e çlodhëse për të gjithë fëmijët”*.
4. Përfshirja e TKOBAP-së në realizimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës Thirrja IX me angazhimin e dy të rinjve në fushën juridike dhe të marketingut.
5. Zhvillimi i Masterclasseve nga E. Jaho dhe Masterclass-i me sopranon Donata d’Annunzio Lombardi nga data 3-7 mars 2024 për të rinjtë dhe jo vetëm si dhe Masterclass-i dyditor mbi repertorin e koreografit Jiri Kylian me praninë e Edi Blloshmi dhe Stefan Zeromski, asistentit të koreografit çek Jiri Kylian me balerinët e TKOBAP-së më 18 dhe 19 prill 2024.
6. Koncertet gjithëpërfshirëse në kuadër të 80-Vjetorit të Çlirimit pas ndjekjes së masterizimit “Disqeve të gramafonit me muzikë nga filma shqiptarë të luftës” në kuadër të organizimit të projekteve referuar “Vitet Mbarëkombëtar të 80-Vjetorit të Çlirimit”.
7. Zhvillimi i International Contemporary Dance Festival në TKOBAP me risi përfshirjen e baletit “VICEVERSA” e cila erdhi me koreografinë e punonjësit të TKOBAP, Julind Dervishi.

- Konkretisht në shifra analitike angazhimin e talenteve të reja gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, 2022,2023 dhe 2024.

Promovimi i artistëve të rinj

Përshkrimi	2021	2022	2023	2024
Numri i artisteve të rinj, pjesë e produksioneve të TKOBAP-së	136	199	206	225

-Edukimi i publikut me veprat më të mira të teatrit muzikor koreografik dhe folklorit të përpunuar.

Edukimi përmes artit është tashmë një nga objektivat më të suksesshme të teatrit tonë, një objektivi aq prioritar e mirë i organizuar dhe implementuar, sa tashmë ka kalendarin e tij të shpallur në fillim të cdo sezoni. Të gjithë trupat artistike, drejtorja e prodhimit dhe marketingut janë të përfshira me të njëjtin seriozitet në këtë kalendar, i cili po shënohet tashmë, si një nga prioritetet e teatrit tone.

Përmes kalendarit të edukimit, në jo vetëm edukojmë fëmijët me artin klasik skenik dhe folklorin, jo vetëm sigurojmë spektatorin e së ardhmes, por përfitojmë edhe produktin artistik të angazhimit të tyre në titujt operistik a koncertal të teatrit.

Efienca e fushatës së marketingut

Të ideojmë dhe të zbatojmë politika të reja kreative promocionale e marketingu, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e audiencave, si edhe ta fusim TKOBAP në tregun e reklamave për të rritur të ardhurat e buxhetit të tij .

Rritja e numrit të ndjekësve të TKOBAP është bazuar në një strategji shumë eficiente, duke vazhduar me rigorozitet punën gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2024 edhe pse në kushte të vështira financiare për një buxhet të përcaktuar për marketingun, duke përshtatur çdo ditë për promovimin e kalendarit artistik.

1. Arritjet kryesore gjatë vitit 2024 për sektorin e marketingut:

- **Rritja e ndërgjegjësimit për TKOBAP:** Përmes fushatave të marketingut në mediat sociale dhe tradicionale, arritëm të rrisim audiencën tonë me 55.6% krahasuar me vitin e kaluar duke cuar numrin e ndjekësve në instagram +28.000 dhe në facebook +35.000 dhe një shikueshmëri e cila ka kaluar shifrën e 1,097,256,679 shikimeve.
- **Promovimi i eventeve artistike:** Organizimi i fushatave promocionale për më shumë se 176 shfaqje gjatë vitit artistik.
- **Përdorimi i kanaleve të reja online:** Zgjeruam praninë tonë në platforma si TikTok dhe LinkedIn për të angazhuar audiencë të reja.
- **Zbatimi i strategjive të reja:** Përdorimi i një qasje të personalizuar për të targetuar audiencë të reja për shfaqjet e kalendarit artistik duke cuar operën tek publiku artdashës.

Si e mbuloi dhe e përballoi këtë skemë të re performancash departamenti i marketing publicitetit:

Tabela 3

Përshkrimi	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2022	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2024
Efienca e Fushatave te Marketingut				

Numri i publikut fizik	7,981	15,639	28,825	31,935
Numri i kronikave te lajmeve	80	93	184	250
Numri i shfaqeve ne emisione televizive	50	53	78	107
Numri i artikujve te botuar	150	140	352	513
Numri vizitoreve ne rrjete sociale, FB. Insta.	1,675,905	2,177,771	5,820,693	9,762,453

Sic shikohet edhe në tabelën e mësipërme kemi një rritje të publikut që na ka ndjekur nëpërmjet rrjeteve sociale si facebook, instagram dhe youtube gjatë sezoneve artistike Janar-Dhjetor 2021,2022,2023 dhe 2024

Rritja e numrit të publikut dhe ndjekësve të shfaqeve të TKOBAP është rezultat edhe i një fushate tejet ritmike që për periudhën Janar-Dhjetor 2024 shënon kulmin e prezencës, publikimeve, prodhimeve promocionale. Kjo ka ardhur si rezultat i një pune me ambicie të lartë për të realizuar një kalendar eskuziv me premiera, koncerte masterclass etj.,.

- Marketing Ndërkombëtar.

Anëtarësimi në Opera Europa.

TKOBAP i ka kushtuar një rëndësi të vecante edhe pasqyrimin të aktivitetit të tij në rang ndërkombëtar. Kjo kryesisht është realizuar përmes anëtarësimit të këtij institucioni në instancën më të madhe ndërkombëtare të teatrove operistike, Opera Europa, ku marrin pjesë shumica e teatrove Europiane. Ky anëtarësim ka ndihmuar TKOBAP vec të tjerash edhe për të ekspozuar prodhimet e tij ndaj audiencës ndërkombëtare, për të promovuar artistët e tij ndaj agjensive ndërkombëtare të menaxhimit të artistëve, apo për tu afruar më shumë me kompani të medha operistike përmes promovimit të teatrit dhe produksioneve të tij në botimet dhe rrjetin mediatik të Opera Europa.

Anëtarësimi në Opera Base.

Operabase është një bazë të dhënash globale në internet për audiencë dhe profesionistë. Ajo liston detaje mbi shfaqjet e operas, teatrot e operas dhe kompanitë e operas, dhe interpretuesit si dhe agjentët e tyre. Ajo u themelua në vitin 1996 nga softueri anglez inxhinier dhe dashamirës i operas Mike Gibb. Operabase është e specializuar në mbrojtjen e dimensionit ndërkombëtar të operas. Dinamika e saj e re u ofron të gjitha kompanive dhe festivaleve operistike platformën ideale ndërkombëtare për informim dhe prezantim publik. Sistemet e informacionit të Operabase (faqja e internetit, baza e të dhënave, listat e postimeve) ofrojnë:

- një ndalesë, akses i lehtë në faqet e internetit të anëtarëve.
- libër adresash i përditësuar për të lehtësuar komunikimin dhe pjesëmarrjen.
- lista postare për mundësitë e rrjeteve të specializuara

- një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse e planeve të ardhshme të prodhimit të shumë anëtarëve.
- një treg bashkëpunues për bashkëprodhime, qira dhe shkëmbime.

Procesi i Integritimit European dhe bashkëpunimi me të tretët, bashkëpunimi me institucionet e huaja:

1. Lidhja e një kontrate shërbimi mes TKOBAP-së dhe BE-së (që u përfaqësua nga Kreu i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri) për organizimin e baletit “Fatalita” si një balet i cili promovoi të drejtat e grave dhe fuqizimin e tyre në Shqipëri përmes artit.
2. Studentë italianë janë angazhuar në Orkestrën Simfonike të TKOBAP me fonde të mirëpërcaktuara nga programi “Erasmuss +” i krijuar për studentët nga Bashkimi Evropian.
3. Bashkëpunimi me shtetet pjesë të BE si: Bullgari me anë të Theatre and Music Production Centre - Varna, mbi skenografinë dhe kostumografinë e operës “La Boheme” dhe të operës "Samson et Dalila" dhe me të tjerë sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit të caktuara në vijim.
4. Marrëveshjet me Izraelin, si një shtet përtej BE dhe Evropës. Marrëveshja mes TKOBAP dhe The Israeli Opera për kostumografinë, skenografinë dhe rekuizitën e operës “Lucia di Lammermoor” dhe Kontrata sponsorizimi me Ambasadën e Shtetit të Izraelit në Shqipëri për koncertin instrumental-simfonik premierë “Qershori romantik” nën dirigjimin e z. Amos Talmon, por edhe me Ambasadën e Spanjës në Shqipëri për baletin “Fatalita”.

Marrëveshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit:

1. Kontrata e bashkëpunimit mes TKOBAP-së dhe Don Branko Sbutega Foundation për realizimin e koncertit “Carmina Burana” në kuadër të KotorArt International Festival në Kotorr, Mali i Zi më 13 korrik 2024.
2. Kontrata e bashkëpunimit mes Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe Fondacionit për Gjakovën në kuadër të realizimit të koncertit “Festë të madhe ka Shqiptaria” më 23 nëntor 2024 në Gjakovë, Kosovë.
3. Kontrata e bashkëpunimit mes TKOBAP dhe Musical association “FONDAZIONE FESTIVAL PUCCINIANO” për realizimin e koncertit "Messa di Gloria" në Torre del Lago, Itali.
4. Kontrata e bashkëpunimit mes TKOBAP-së dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Athinë në kuadër të realizimit të koncertit të datës 25 nëntor 2024 në Athinë, Greqi.
5. Kontrata e bashkëpunimit mes TKOBAP-së dhe SUSTAINABLE DEVELOPMENT ORGANIZATION ALBANIA (SDOA) me qëllim realizimin e koncertit dhe baletit "Giselle" më 7 nëntor 2024 në Teatrin Oratorio, Salla Magna në Majorca, Spanjë.
6. Kontrata e bashkëpunimit mes TKOBAP-së dhe Ilaria Scaffardi Artists Management për realizimin e baletit “Arrëthyesi” më 11, 12, 13 dhe 14 dhjetor dhe 5 e 6 janar 2025 në Itali.
7. Kontrata e bashkëpunimit mes TKOBAP dhe Theatre and Music Production Centre – Varna mbi skenografinë dhe kostumografinë e operës “La Boheme” dhe të operës "Samson et Dalila".

8. Kontrata e bashkëpunimit mes TKOBAP dhe “The PLAZA Tirana sh.p.k” për akomodimin për znj. Ermonela Jaho dhe të z. Charles Casanova në kuadër të realizimit të koncertit vokalo-simfonik nga sopranoja me famë ndërkombëtare Ermonela Jaho dhe tenori Charles Castronovo më 4 gusht 2024 në skenën e TKOBAP-së.
9. Kontrata e bashkëpunimit mes TKOBAP dhe “The PLAZA Tirana sh.p.k” për sigurimin e veshjeve skenike dhe aksesoreve për znj. Ermonela Jaho dhe të z. Charles Casanova në kuadër të realizimit të koncertit vokalo-simfonik nga sopranoja me famë ndërkombëtare Ermonela Jaho dhe tenori Charles Castronovo më 4 gusht 2024 në skenën e TKOBAP-së.
10. Kontrata e bashkëpunimit mes TKOBAP-së dhe Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë që kishte si objekt vënien në dispozicion të hollit koncertor të TKOBAP-së Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë në kuadër të organizimit të koncertit të kompozitores znj. Blerina Shalari për datat 27 dhe 28 janar 2024.
11. Kontratat e bashkëpunimit me qendrën “Mirazh” dhe qendrën “Dragoi Blu” përkatësisht për nevoja të operave “Tosca” dhe “Lucia di Lammermoor” etj.

Një nga objektivat kryesore të TKOBAP është rritja e vazhdueshme e cilësisë artistike dhe tërheqja e një audience në rritje. Një element shumë i rëndësishëm i këtij objektiwi është edhe paraqitja skenike e artistëve dhe e skenës në tërësi. Pasurimi i garderobës së teatrit është një nga sfidat më të rëndësishme të cdo produksioni si dhe kërkon investimin më të madh në raport me buxhetin. Kjo u bë e mundur fal uljes së shpenzimeve për cilësinë artistike si dhe objektiveve të vendosura për ti dhënë prioritet në këtë sezon artistik investimeve në skenografi dhe kostumografi.

Institucioni ka zhvilluar audicione dhe ka plotësuar vendet vakante duke punësuar 10 (dhjetë) artistë të rinj në këto sektorë:

1. Audicioni pranë Sektorit të Orkestrës Simfonike, Drejtoria e Operës dhe Filarmonisë -1 vend (Spalë Sektori Orkestra, instrumenti violinë) Data e zhvillimit 15.12.2023.
2. Audicioni pranë Drejtorisë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore -1 vend (Orkestrant Kategoria e Parë, instrumenti fizarmonikë) Data e zhvillimit 18.1.2024.
3. Audicioni pranë Sektorit të Solistëve Lirike, Drejtoria e Operës dhe Filarmonisë -1 vend (Solist i Dytë Lirik, regjistri i zërit tenor) Data e zhvillimit 27.3.2024.
4. Audicioni pranë Sektorit të Orkestrës Simfonike, Drejtoria e Operës dhe Filarmonisë -1 vend (Orkestrant i Kategorisë së Parë, instrumenti trombë) Data e zhvillimit 3.4.2024.
5. Audicioni pranë Sektorit të Korit, Drejtoria e Operës dhe Filarmonisë -1 vend (Korist i Kategorisë së Parë, regjistri i zërit tenor) Data e zhvillimit 4.4.2024.
6. Audicioni pranë Sektorit të Korit, Drejtoria e Operës dhe Filarmonisë -1 vend (Korist i Kategorisë së Parë, regjistri i zërit bas/bariton) Data e zhvillimit 4.4.2024.

7. Audicioni pranë Sektorit të Korit, Drejtoria e Operës dhe Filarmonisë -1 vend (Korist i Kategorisë së Parë, regjistri i zërit soprano) Data e zhvillimit 15.5.2024.
8. Audicioni pranë Sektorit të Orkestrës Simfonike, Drejtoria e Operës dhe Filarmonisë -1 vend (Orkestrant i Kategorisë së Parë, instrumenti oboe me detyrim korno angleze) Data e zhvillimit 20.5.2024.
9. Audicioni pranë Sektorit të Orkestrës Simfonike, Drejtoria e Operës dhe Filarmonisë -1 vend (Orkestrant i Kategorisë së Dytë, instrumenti kontrabas) Data e zhvillimit 16.9.2024.
10. Audicioni pranë Drejtorisë së Baletit -1 vend (Pianist korepetitor) Data e zhvillimit 21.10.2024.

Iniciativat legislative, aktet nënligjore gjatë 2024 për punësimin e artistëve të rinj:

1. Në zbatim të pikës 2 të nenit 21 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, është iniciuar procedura për shtesa në organikën e TKOBAP-së.
2. Në mbështetje të Vendimit nr. 109, datë 6.3.2019 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve në kryerjen e disa aktiviteteve me punonjës të përkohshëm, në njësitë e qeverisjes qendrore”, është depozituar kërkesa për punonjës të nevojshëm me kontratë të përkohshme dhe kohë të pjesshme për vitin 2025 nga TKOBAP-ja.

MJEDISI I KONTROLLIT

➤ Vendosja e objektivave

Në njësinë tonë organizative është krijuar një mjedis i përshtatshëm kontrolli i cili shërben si instrument për menaxhimin e mirë të fondeve publike si dhe për të gjithë komponentët e tjerë të menaxhimit financiar e kontrollit.

➤ Etika personale e profesionale

Lidhur me etikën personale dhe profesionale jemi mbështetur mbi ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i korrigjuar, ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, ligjit nr. 10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, Statutin e TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 si dhe

në Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e TKOBAP-së” e miratuar së fundmi pas konsultimeve me përfaqësues të secilës prej Sektorëve përkatës të Drejtorive përbërëse të TKOBAP-së dhe Sindikatës së TKOBAP-së ku janë parashikuar standardet e sjelljes në detyrë, respektimi e zbatimi i detyrave, informimin për parregullsitë, ndjekja e procedurave të ankimit, profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrës konform dispozitave ligjore e nënligjore, standartet jashtë pune, marrëdhëniet me eprorët, sjelljen ndaj publikut, përgjegjësitë në rast të shkeljeve të rregullave të etikës.

Kjo bazë ligjore ndihmoi në implementimin e kërkesave të parimeve më të rëndësishme të etikës siç janë ligjshmëria, paanësia dhe mungesa e konfliktit të interesave, ku janë përcaktuar rregullat, mjetet, mënyrat dhe procedurat për identifikimin, deklarimin, rregjistrimin, trajtimin, zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave si dhe sanksionet për shkeljen e kësaj rregulloreje.

Rritja e ndërveprimit me Sindikatën e TKOBAP-së pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit mes palëve.

Forcimi i kapaciteteve administrative:

1. Ndjekja e Urdhrit të Brendshëm “Për caktimin e procedurës për shqyrtimin e ankesave për diskriminim të cilat depozitohen nga punëmarrësit” më 15.2.2024 në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me synim rritjen e besimit të artistëve në zgjidhjen e çështjeve që lidhen me parashikimet e urdhrit si më lart cituar.
2. Publikimi i akteve ligjore, nënligjore dhe i akteve të brendshme që lidhen me organizimin dhe funksionimin e institucionit në web-in zyrtar të TKOBAP-së sipas publikimeve dhe përditësimeve të tyre në Qendrën e Botimeve Zyrtare me synim njohjen e tyre nga punonjësit e TKOBAP-së dhe çdo vizitori në web-in e institucionit.
3. Publikimi i Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar me synim mbrojtjen e parimit të transparencës së institucionit.
4. Zbatimi i orarit standard ose fleksibël për punonjësit e administratës së TKOBAP në zbatim të VKM nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar.

➤ Stili Menaxherial

Përsa i përket stilit menaxherial është ndjekur praktika e zhvillimit të takimeve të rregullta të menaxhimit për diskutimin e çështjeve themelore të menaxhimit me drejtorët e drejtorive artistike, të produksionit dhe jo vetëm po edhe me përgjegjësit e zyrave, e cila është parashikuar dhe në

Statutin e TKOBAP-së, në rregulloren e brendshme të Institucionit në fuqi si dhe me vendimet përkatëse të sektorëve.

➤ **Monitorimi**

Raportet e monitorimit pranë organeve monitoruese të TKOBAP-së janë: Situacionet Mujore, Raportet e Parashikimit dhe Realizimit të Prokurimeve Publike, Pasqyrat Financiare mbi mbylljen e vitit buxhetor, Statistikat 3-mujore mbi numrin dhe pagat e punonjësve.

Gjatë vitit nga sektori i finances kerkohen rakordime te ndryshme me Degën e Thesarit konkretisht dërgohet në mënyrë periodike cdo muaj Evidenca e Shpenzime qe paraqet gjendjet e buxhetit si dhe realizimin e tij në mënyrë progresive, Evidenca e rakordimit të të ardhurave që paraqet në mënyrë progresive të ardhurat dytësore të institucionit si dhe rritjet e autorizuara të bëra gjatë vitit.

Gjithashtu gjatë vitit dërgohen raportime në Ministrine e linjës mbi evidencat dhe rakordimet e mbyllura me Degën e Thesarin si dhe Situacioni i muajit, Raporti i Monitorimit cdo 4, 8 dhe 12 muaj, Raporti i Valutës së huaj cdo 3, 6, 9, 12 muaj, Evidenca e shitjes së biletave në mënyrë progresive brenda datës 3 të cdo muaji, si dhe raportime të tjera mbi tematika të ndryshme në varësi të nevojave.

Monitorimi bëhet edhe nga përgjegjësit e sektorëve, lidhur me realizimin e detyrave të vartësve të tyre. Përgjegjësit e sektorëve japin informacione javore të punës së kryer, raportojnë çdo javë. Informacione periodike, për të pasur një paraqitje dhe njohuri të përditesur të situatës ekonomike-financiare të aktivitetit në tërësi, në përmbushje të objektivave si dhe mangësite e vërejtura.

Sipas kërkesave të TKOBAP, MEKI dhe Sindikata kanë përzgjedhur përfaqësuesit e tyre për të qenë prezent si pjesë e komisioneve, pa të drejtë vote, me qëllim mbikëqyrjen e procedurave të audicioneve të zhvilluara në TKOBAP në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje. Të gjitha audicionet e zhvilluara përgjatë 2024 kanë rezultuar të suksesshme dhe punonjësit janë ndjekur nga vlerësime pozitive në përfundim të periudhës së provës nga eprorët përkatës.

Auditimi i ushtruar nga MEKI në institucion për periudhën 01.01.2022 deri më 30.06.2024 në vijim të kërkesave zyrtare të TKOBAP. Rezultati sipas gjetjeve dhe observacioneve të dokumentuara.

Konkluzion

Në konkluzion, përgjatë periudhës së analizuar Janar-Dhjetor 2024 TKOBAP shifrat tregojnë rritje të numrit të audiencës, gjithashtu rritje sa perket diversitetit të titujve që tërheq audiencë, ne angazhohemi se me propozimin e Kalendarit Artistik kemi programuar më shumë kreativitet

në shfaqje, me premiera, oprea, koncerte në mënyrë që të rrisim audienat e rinisë dhe fëmijëve si audienca strategjike që të sigurojnë vazhdimësinë e publikut të TKOBAP. Ne duhet të synojmë rritjen e cilësisë artistike në vazhdimësi për të qenë partnere të denjë për bashkepunimet që na presin me teatrot europiane e madje duhet të nxitojmë të rrisim sa më shumë nivelin artistik të shfaqjeve tona.

Repertori strategjik do të jetë Opera – Balet – Koncerte

Opera

Ne do të ofrojmë vepra që përfshijnë një periudhë të gjerë, nga fillimet e operas e deri në ditët tona.

Do të fokusohemi më shumë në maksimizimin e kualitetit dhe dinamikës së shfaqjeve me qëllimin final atraksionin e audienave.

Titujt artistikë të sezonit tonë do të jenë tituj të cilët do të lartësojnë Teatrin e Operas, për jetën tonë, dhe se si ajo qëndron në qendër të artit. Tematikat e sezoneve tona do t'i ofrojnë shikuesve mundësinë e përqasjes së temave të mëdha të kryeveprave operistike me idetë dhe çështjet e jetës, do t'i frymëzojë për problematikat aktuale sociale e politike.

Ne do të ofrojmë një sezon tematik me 3-4 tema, ku secila do ilustrohet me tituj kryeveprash që do të përfshijnë interesat jo vetëm të audienave ekzistuese, por shumë më gjerë. Një eksperiencë e tillë programatike në kalendarin artistik është një trend në pjesën më të madhe të teatrove ndërkombëtar.

Baleti

Me ambicie të fortë për propozim e kalendarit artistik kemi dhe tituj të rëndësishëm të baletit. Do të angazhohemi që vec veprave klasike, të eksplorojmë edhe më shumë dansin kontenporan, qëllimi i të cilit shpesh është që të ndryshojë perceptimin e artit në mënyrë që publiku duke parë shfaqjet tona të përjetojë një experiencë krejt të re.

Duke mbajtur në repertor koreografite më të mira klasike me yje botërore, do të fokusohemi edhe në veprat më të vlerësuara kontenporane, si edhe në vepra origjinale ekskluzive, duke kontribuar në cuarjen përpara të formave dhe shprehjeve të reja të krijimit të gjeneratës së re të artit koreografik dhe interpretimit të tij.

Synimi ynë është që trupa jonë e baletit të krijojë autoritetin e një trupe ndërkombëtare me nivele të larta në interpretim.

Koncerte

Koncertet do të jenë gjithashtu një nga tre dimensionet e produksioneve tona artistike.

Angazhohemi që brenda formacionit kryesor orkestral të formatojmë edhe dy formacione të vogla me nivel të lartë artistik, komode për turnete dhe të aksesueshme për publikun. Këto

formacione do të jenë të pranishme në të gjithë Shqipërinë, duke filluar nga teatrot më të rëndësishme të vendit e deri tek ato të bashkive të vogla.

Koncertet dhe turnete e këtyre formacioneve do të rrisin angazhimin artistik të trupave artistike në kalendarin e sezoneve, dhe për pasojë do të ngrejë më lart nivelin artistik të Orkestres, Korit, Baletit, dhe Ansambilit Popullor me synim pjesëmarrjen e tyre në aktivitete dhe konkurse ndërkombëtare.

Ansambli Popullor

Artistet dhe drejtuesit e AP ndër vite kanë qenë “mbrojtësit” më besnikë të vlerave të folklorit muzikor ,koreografik, etnografik, etj. Sot, zhvillimet e reja social-ekonomike të Shqipërisë, fuqizimi i ekonomisë së turizmit, hapin perspektiva të madha për trashëgiminë kulturore, dhe sigurisht edhe në këtë oaz trashëgimie, Ansambli Popullor ka vendin dhe rolin e tij tejet të rëndësishëm.

Nisur nga këto perspektiva ne do të angazhohemi që kalendarit artistik të Ansambilit Popullor, t’i bashkëngjitet destinacione të gjera gjeografike në përhapjen e vlerave kulturore të pjesës polifonike, valleve etj .Tituj të ri do të ndihmojnë në përhapjen e vlerave që sjell ky ansambël dhe në rritjen e audiencës.